

**VENDIM**  
**Nr. 271, datë 9.7.2021**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME SELENICË SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 9.7.2021 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Selenicë sh.a.’”,

**VËREN SE:**

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Selenicë (UK Selenicë), me shkresën përcjellëse nr. 287 prot. ERRU, datë 24.12.2020, me lëndë “Dërgim dokumentacioni për rinovim licence” dhe me shkresën nr. prot. nr. 405, datë 7.6.2021, “Dërgim dokumentacioni plotësues për rinovim licence”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencimin e shoqërisë për kategorinë A të shërbimit – grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik dhe kategorinë C të shërbimit – largimi i ujërave të ndotura. Shoqëria ka paraqitur kërkesën për licencim për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Selenicë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Selenicë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 18 662 banorë të Bashkisë Selenicë;

b) Drejtues teknik i shoqërisë z. Kendi Manaj është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, dega “Hidroteknikë”, në vitin 2018.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Selenicë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Selenicë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

**VENDOSI:**

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Selenicë sh.a. me (NUIS K47127201C), në kategoritë:

a) kategoria A – për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C – për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Selenicë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor: Martin Dana;

b) drejtues teknik: Kendi Manaj.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Selenicë sh.a. është Bashkia Selenicë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Selenicë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Selenicë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYETAR**

**Fatime Imeraj**